

SH.A UJËSJELLËS-KANALIZIME, TIRANË
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik JV“Kombeas” sh.a &”Arjeli”sh.p.k përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.7210/1 rep. dhe nr.4402/1 kol., nga shoqëria “Kombeas” sh.a me NIPT K88103301J, me administrator Z. Astrit Nabolli, me adresë: Milot, Kurbin.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Reabilitim rrjeti kanalizimi në rrugën “Don Bosko” (duke përfshirë rrugën “Egnatia”)

Fondi Limit: 25,382,378 (njëzet e pesë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjetllës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja e kontratës: 45 ditë duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Data e zhvillimit të tenderit është: 27/06/2016 Ora: 09:00.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr 22 datë 06/06/2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**BEAN**” sh.p.k NIPT J72510445Q
Vlera: **23,127,790** (njëzet e tre milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik JV “**Ndregjoni**” sh.p.k NIPT K31329048I
& **Ndërtimi sh.p.k.** NIPT K11325002C
Vlera: **23,612,290** (njëzet e tre million e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik JV“**Kombeas**” sh.a NIPT K88103301J
&”**Arjeli**”sh.p.k NIPT K31320002C
Vlera: **24,784,768** (njëzetë e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “**BEAN**” sh.p.k, me nr. NIPT-i J72510445Q, me administrator Zj. Eva Sadushi, me ofertë ekonomike me vlerë prej 23,127,790 (njëzet e tre milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili **ka** mangësi në dokumentacionin e

kërkuar në Dokumentat e Tenderit në përputhje me Kriteret e Përgjithshme dhe të Veçanta të Pranimit/Kualifikimit si më poshtë:

- Për këtë operator ekonomik Autoriteti Kontraktor UKT sh.a. mbështetur në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 13, pika 3, gërma a me anë të shkresës Nr. 14889 Prot datë 29.06.2016 ka bërë kërkesë për përjashtim nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik nga për arsye se:
Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “BEAN” sh.p.k. për tenderin me objekt “Reabilitim rrjeti kanalizimi në rrugën “Don Bosko” (duke përfshirë rrugën “Egnatia”) është paraqitur përsëri fletë doganimi me Nr. R 24117 datë 26.03.2015, me anë të të cilit janë zhdoganuar makineri të tjera si më poshtë:

- Makineri për prodhimin e kesoneve
- Makineri për pastrimin e argjilës në kanal

Për fletë doganimit e mësipërm i është kërkuar informacion Doganës Durrës, në lidhje me makineritë e zhdoganuara me shkresën Nr. 14524 Prot. datë 22.06.2016.

Kërkesës së mësipërme i është kthyer përgjigje nga Dogana Durrës me shkresën Nr. 10747/1 Prot. datë 28.06.2016, nga ku rezulton se me fletë doganimit Nr. **R 24117** datë **26.03.2015**, nuk është zhdoganuar asnjë prej grupeve të mësipërme të makinerive, por ekskavator i përdorur New Holland komplet me nivelues 1 copë, V.P-2006.

Nga sa më sipër operatori ekonomik “BEAN” sh.p.k. rezulton se ka paraqitur dokument të falsifikuar për këtë objekt prokurimi.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik JV “Ndregjoni” sh.p.k & Ndërtimi sh.p.k. përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. 7212/1 rep. dhe nr.4404/1 kol., nga shoqëria “NDREGJONI” sh.p.k, me nr. NIPT-i K31329048I, me administrator Z.Xhetan Ndregjoni, me ofertë ekonomike me vlerë prej 23,612,290(njëzet e tre million e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.,si **pasoje e tërheqjes së ofertës ekonomike për arsye të paparashikuara personale.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **JV“Kombeas” sh.a &”Arjeli”sh.p.k** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.7210/1 rep. dhe nr.4402/1 kol., nga shoqëria “**Kombeas” sh.a** me NIPT K88103301J, me administrator Z. Astrit Nabolli, me adresë: Milot, Kurbin, me ofertë ekonomike me vlerë prej **24,784,768** (njëzetë e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, se është **identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga “5 Maji” pranë Medresesë, Tiranë, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 01.07.2016.

Ankesa: Ka ardhur ankesa Nr. 15208 Prot. Datë 06.07.2016. nga operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k, të cilës i është kthyer përgjigje me shkresën Nr. 15208/1 datë 08.07.2016, duke mos pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

Gjatë afatit ligjor për ankesë në KPP: Është paraqitur Ankesë Nr. 15758 Prot. datë 15.07.2016 nga operatori ekonomik "BEAN" sh.p.k.

Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr. 642/2016 datë 24.08.2016, ka vendosur:

- 1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "BEAN" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e Hapur" me numër Ref-40110-05-31-2016 me objekt "Reabilitim rrjeti kanalizimi në rrugën "Don Bosko" (duke përfshirë rrugën "Egnatia"), me me fond limit 25,382,378 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 27.06.2016 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Tiranë.*
- 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.*